



Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, 15.09.2016

## LETËR E HAPUR

**Drejtuar:** Z. *Blendi Klosi*, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;  
Z. *Ylli Manjani*, Ministër i Drejtësisë;  
Zj. *Lindita Nikolla*, Ministër e Arsimit dhe Shkencës;  
Z. *Bledi Cuçi*, Ministër Shteti për Çështjet Vendore;  
Z. *Illir Beqja*, Ministër i Shëndetësisë;  
Zj. *Elona Gjebrea*, Zv.Ministër e Punëve së Brendshme;  
Kryetarëve të Njësisve të Qeverisjes Vendore *Tiranë, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Pogradec, Peshkopi, Durrës, Sarandë*

**Për dijeni:** Z. *Fatmir Xhafa*, Kryetar i Komisionit të Ligjeve, Kuvendi i Shqipërisë  
  
Zj. *Albana Vokshi*, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Kuvendi i Shqipërisë  
  
Zj. *Olta Xhaçka*, Kryetare e Nënkomisionit për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore, Dhunës në Familje, Kuvendi i Shqipërisë

**Lënda:** **Për garantimin e shërbimeve rehabilituese ndaj personave të paditur/dhunues në rastet e dhunës në familje**

I/E nderuar Z.Zj \_\_\_\_\_

**1.** Dhuna në familje<sup>1</sup> është një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare dhe kjo e bën të pamundur matjen me saktësi të përmasave të një fenomeni të tillë.

Dhuna në familje është trajtuar më shumë si një problem individual i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë. Kjo është përgjegjësi e shtetit dhe individëve për të marrë

---

*1 Në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhuna përkufizohet si "veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik". Si rrjedhojë, dhuna në familje përkufizohet si "çdo akt dhune i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare".*



hapa efektive për të mbrojtur gratë dhe fëmijët si dhe për të parandaluar dhunën. Statistikat tregojnë se ende 5-15 % e grave të dhunuara raportojnë dhunën. Studimet tregojnë se dhuna në familje, veçanërisht kundër grave dhe vajzave, është rritur gjatë periudhës së tranzicionit.

Pavarësisht kuadrit ligjor në Shqipëri, problemi qëndron në faktin se viktimat nuk e konsiderojnë dhunën në familje si një krim ose ato frikësohen nga raportimi i incidenteve pasi mund të shkaktojë turp mbi familjet e tyre. Arsye të tjera të mosraportimit të dhunës ose të mosankimit në lidhje me të, është pamundësia e tyre për të mbështetur financiarisht veten dhe fëmijët kur ata largohen apo divorcohen nga partnerët e tyre.

Ky problem i komplikuar me rrënjët e tij në marrëdhëniet bashkëshortore, ka një ndikim negativ edhe në prindërim. Gratë që janë viktime të dhunës në familje kanë zakonisht vështirësi të përqëndrohen dhe në mënyrë efikase të punojnë me fëmijët e tyre, janë më të prirur për shmangie apo mohim të situatës dhe e neglizhojnë ndikimin e dhunës mbi veten dhe fëmijët e tyre. Këto nëna rrezikojnë të vriten apo të plagosen seriozisht dhe në shumicën e kohës ata vuajnë nga dhimbjet kronike, depresioni, çrregullime psikosomatike, shtatëzani të padëshiruara, aborte spontane dhe kështu me radhë. Rolet që luajnë të gjithë pjesëtarët e një familjeje abuzive reflektojnë se si çdo person i përshtatet dhe mësohet me fshehtësinë, intrigat, dhe me situatën e rrezikshme në të cilën ata jetojnë. Një njeri abuziv shkatërron përpjekjet e një nënë për të prindëruar, qoftë duke e kundërshtuar atë, duke dobësuar besimin e saj si një prind, apo duke ndryshuar pikëpamjen e fëmijëve të saj ndaj nënës duke mos e konsideruar si një person të denjë për respekt.

Dhuna në familje konsiderohet si një formë e abuzimit të fëmijëve, ku fëmijët preken në mënyrë të pashmangshme nga ky fenomen. Ajo mund të marrë formën e një ose më shumë incidenteve traumatike që mund të shkaktojnë një ndryshim të papritur dhe ndryshon mënyrën se si fëmijët mendojnë dhe ndjehen - për veten, familjet e tyre dhe jetën në përgjithësi.

**2.** Sipas nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të gjitha konventat e ratifikuara nga Shqipëria bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe rrjedhimisht drejtpërdrejt të zbatueshme. Në vijim, Shqipëria është pjesë e konventave të mëposhtme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, e ratifikuar më 4 tetor 1991;
- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e ratifikuar më 4 tetor 1991;
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) e ratifikuar më 27 shkurt 1992. Kjo konventë i siguron shtetit një autorizim të qartë për mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme dhune në shtëpi dhe familje dhe përcakton rolin e tij si një arbitër kryesor për mirëqenien e fëmijës në ambientin familjar;
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese, e ratifikuar më 11 maj 1994;



- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar më 11 maj 1994. Kjo konventë është konsideruar si “një biletë ndërkombëtare të drejtash” për gratë. Ajo e përkufizon diskriminimin në një mënyrë shumë të qartë, duke treguar se gratë kanë të drejtë që të gëzojnë të drejta njerëzore të barabarta dhe të plota;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të ratifikuara më 10 shkurt 1996;
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese, e ratifikuar më 10 shkurt 1996;
- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

*Si pjesë e së drejtës së brendshme, kuadri ligjor përfshin:*

- Neni 18 i Kushtetutës thekson “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës dhe bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore”. Më tej, neni 54/3 siguron se çdo fëmijë ka të drejtë “të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”.
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (ndryshuar) ka për qëllim të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të garantojë mbrojtje me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje.
- Ligji nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (ndryshuar) sanksionon të drejtën për tërheqjen e ndihmës ekonomike jo vetëm nga kryefamiljari, por edhe nga gratë e dhunuara në rastet kur ato pajisen me UM/UMM; si dhe parashikon mbështetjen me ndihmë ekonomike të familjeve në kohën kur bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martesë. Ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare përfitohet për periudhën e vlefshmërisë së UM/UMM-ve.
- Kodi Shqiptar i Familjes përfshin gjithashtu nenin të ndryshme lidhur me dhunën në familje ndaj bashkëshortes/it dhe fëmijëve. Ai përcakton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijës në jetën familjare, si dhe abuzimin dhe neglizhimin ndaj fëmijës. Për shembull, neni 62 thotë se “bashkëshorti abuzues duhet të largohet nga banesa bashkëshortore”. Ky nen, sidoqoftë, nuk ka masa të tjera procedurale.
- Ligji nr.8876, datë 4 prill 2002, “Mbi Shëndetin Riprodhues” përcakton se çdo grua duhet të vendosë me vullnetin e saj të lirë dhe pa ndonjë formë diskriminimi, detyrimi apo dhunë për të gjitha çështjet që lidhet me seksualitetin e saj dhe shëndetin e saj seksual e riprodhues.
- Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka dispozita që mund të përdoren për të adresuar krime që lidhen me dhunën në familje; disa prej tyre vlejné për abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve. Në këto vepra penale përfshihen, por nuk kufizohen: Vrasja (76-83, 85) (vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, neni 79/b; vrasja e foshnjës, Neni 81); Kanosja (84);



Plagosja e lehtë ose e rëndë me dashje (Neni 88/89); Dëmtime të tjera me dashje, si dhe çdo lloj tjetër akti dhune përbën kundravajtje penale kur shkakton paaftësi të përkohshme për punë më tepër se nëntë ditë (Neni 90); Plagosja e lehtë ose e rëndë nga pakujdesia (Neni 91, 92); Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas (Neni 93); Shkaktimi i vetëvrasjes në marrëdhëniet familjare ose bashkëjetesë (Neni 99, i shtuar); Marrëdhënia seksuale (Neni 100-108/a ); Braktisja e fëmijëve të mitur (Neni 124); Mosdhënia e mjeteve për jetesë (mohimi i mbështetjes së nevojshme për të jetuar për fëmijët, prindërit apo bashkëshortin nga personi i cili është i detyruar nga një vendim gjyqësor t'ua sigurojë këtë, përbën kundravajtje penale) (Neni 125); Kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (Neni 134/141).

Ndryshimet në Kodin Penal, sipas Ligjit nr. 23/2012 datë 1.03.2012, sigurojnë dy nene të posaçme të rëndësishme për dhunën në familje. Neni 124/b përcakton/përfshin mbrojtjen e të miturve edhe nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit, kujdestari ligjor ose nga çdo person i detyruar të kujdeset për ta. Kjo lloj veprë dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet. Neni 130/a e përcakton dhunën në familje duke përfshirë: rrahjen apo çdo vepër tjetër dhune e kryer në mënyrë të përsëritur ose në prani të fëmijëvekanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë; plagosjen me dashje, të kryer nga bashkëshorti/ja; ish-bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëjetuesi/ja, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, si vepër që dënohet me burgim deri në pesë vjet.

3. Ndër vite për reduktimin e fenomenit është punuar kryesisht me gratë dhe vajzat nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve kundrejt kësaj shtrese vulnerabel. Paralelisht janë ngritur struktura dhe përfeksionuar ligje, të kombinuara me fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese, duke lënë mënjane shpesh gjenezën e fenomenit, dhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese për to si masë parandaluese dhe edukuese.

Trajtimi i dhunuesit si një mundësi për rehabilitimin psikologjik, rindërtimin e marrëdhieve njerëzore dhe sociale si dhe mundësitë për ndërmjetësim për ato raste kur dhuna në familje mund të adresohet është një koncept i ri i trajtuar më Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, gjithashtu në Konventën e Stambollit si edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje. 2011-2015.

**Teksa theksi vihet në vënien përpara përgjegjësisë, civile dhe penale të dhunuesit, kjo shihet e kombinuar me nevojën për shërbime rehabilitimi edhe për dhunuesit, për të siguruar largimin e tyre nga sjellja e dhunshme në të ardhmen.** Këto akte kombëtare e ndërkombëtare ngarkojnë me përgjegjësi organet shtetërore kompetente për mundësimin dhe garantimin e programeve rehabilituese për dhunuesit, duke e parë të ngushtë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile si edhe me aktorët e tjere të mekanizmit të referimit.

**Për këtë, nevoja për adresimin e trajtimit rehabilitues të dhunuesve për rastet e dhunës në familje mbetet domosdoshmëri për institucionet përgjegjëse.** Sot në Shqipëri,



*iniciativa e parë në përmbushje të këtij detyrimi adresohet vetëm nëpërmjet shërbimit rehabilitues që ofrohet nga Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (themeluar me 2010) dhe nga Zyra Për Djem dhe Burra (themeluar nga Gruaja tek Gruaja Shkodër në 2014). Numri i rasteve dhe kompleksiteti i tyre, faktorët socialë, shpërndarja demografike e rasteve, kompleksiteti dhe vështirësia në adresimin e nevojave emergjente të viktimës së dhunës në familje ka sjellë në nevojën për adresimin e një qasjeje holistike në punën për rehabilitimin psikologjik të dhunuesve për rastet e dhunës në familje. Përveçse multi-disiplinare, kjo qasje duhet të jetë e vazhdueshme, shumë-planëshe dhe gjithëpërfshirëse.*

Për këtë, si dhe në kuadër të Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje (2016-2019), **Rrjeti për Fuqizimin e Gruas në Shqipëri – AWEN dhe 9 organizatat e tij anëtare kërkojnë marrjen e masave të nevojshme për adresimin e çështjeve të rehabilitimit psiko-social, ku ndër të tjera të përfshihen:**

- Aplikimin e Nenit 10, pika “m” për masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- Njohjen, standardizimin dhe çertifikimin e shërbimit ndaj dhunuesve, si domosdoshmëri për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- Trajtimin psikologjik, psikiatrik dhe mjekësor të rasteve më të rënda, sipas një sistemi të koordinuar referimi mes ofruesve të shërbimit rehabilitues dhe strukturave shtetërore;
- Mbështetjen financiare të shërbimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile në këtë kuadër nga instancat shtetërore.

Sinqerisht,

Ines Leskaj  
Drejtoresh Ekzekutive

**Në emër të:**

Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – **AWEN**

Përbërë nga:

1. Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë;
2. Shoqata për gratë dhe vajzat me problem sociale, Durrës;
3. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
4. Shoqata Unë Gruaja, Pogradec;
5. Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër;
6. Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi;
7. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë;
8. Shoqata Forumi Gruas Elbasan;
9. Shoqata Jona, Sarandë.